



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Drejtoria e Prokurimeve
Nr. _____ Prot.

Date 09.10.2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Date 09.10.2018

Nga: *Bashkia Korçë, rruga "28 Nentori", 082 243353.*

Për: *Shoqëria "Glavenica" sh.p.k, adresa: Fier, Ballsh, Lagj. 5 Shkurti, Bulevardi 4 Heronjte, godina nr.2, apartamenti nr.3, kati 4.*

Procedura e prokurimit: *Procedurë e hapur*

Objekti: *"Sisteme malore"*

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-82485-08-08-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka për qëllim sistemimin e pritave të demtuara të disa perrenjve malore në fushën e Korçës.*

Fondi limit: **16,208,331 leke**

Burimi i financimit: *Te ardhurat e bashkisë*

Investim

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **10.09.2018**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] -

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët*

Njoftojme se, kanë qene pjesemarrës në procedure këta ofertues me vlerat perkatëse të ofruara:

1. Shoqëria "Alesjo" shpk, NIPT L37311801K me vlerë:
9,631,184 (nente milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e kater) leke pa tvsh

2. Shoqeria “Glavenica”shpk, NIPT K17710805A me vlere:
9,856,977 (nente milion e teteqind e pesedhjete e gjashte mije e nenteqind e shtatedhjete e shtate) leke pa tvsh
3. Shoqeria “Nika”shpk, NIPT J76705047U me vlere:
10,417,386 (dhjete milion e katerqind e shtatembedhjete mije e treqind e tetedhjete e gjashte) leke pa tvsh
4. Shoqeria “Fled”sh.p.k, NIPT K17621104C me vlere:
10,649,310 (dhjete milion e gjashteqind e dyzet e nente mije e treqind e dhjete) leke pa tvsh
5. Bashkimi i operatoreve Avdulli NIPT K14721001P dhe Vashtemia NIPT J64103054Q me vlere:
10,687,482 (dhjete milion e gjashteqind e tetedhjete e shtate mije e katerqind e tetedhjete dy)
6. Bashkimi i operatoreve Kuarci Blace NIPT K24207608A dhe Bahas NIPT J61827083D me vlere:
*11,183,125 (njembedhjete milion e njeqind e tetedhjete e tre mije e njeqind e njezet e pese) leke pa
Tvsh,(vlera mbas korrigjimit).*
7. Shoqeria “Rej”sh.p.k, NIPT J93711608Q me vlere:
11,985,980 (njembedhjete milion e nenteqind e tetedhjete e pese mije e nenteqind e tetedhjete) leke pa tvsh.
8. Shoqeria “Shkelqimi 07 ”shpk, NIPT K68121808W me vlere:
12,799,481 (dymbedhjete milion e shtateqind e nentedhjete e nente mije e katerqind e tetedhjete e nje) leke pa tvsh.
9. Shoqeria “Alb Korça 2002”sh.p.k, NIPT K34004003T me vlere:
12,827,267 (dymbedhjete milion e teteqind e njezet shtate mije e dyqind e gjashtedhjete e shtate) leke pa tvsh.
10. Shoqeria “Shamo Construction ”sh.p.k, NIPT L01326020F me vlere:
13,623,729 (trembedhjete milion gjashteqind e njezet e tre mije e shtateqind e njezet e nente) leke pa tvsh.
11. Shoqeria “Kacdedja ”sh.p.k, NIPT K51712017A me vlere:
16,134,382 (gjashtembedhjete milion e njeqind e tridhjete e kater mije e treqind e tetedhjete e dy) leke pa tvsh,(vlera mbas korrigjimit).

12. Shoqeria “Biba - X” sh.p.k, NIPT K32618815N me vlere: 16,050,850.20 (gjashtembedhjete milion e pesedhjetë mijë e teteqind e pesedhjetë pike njezet) leke pa tvsh

* * *

Jane s’kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Shoqeria “Alesjo”shpk, per arsye se:

1.Oferta eshte anomalisht e ulet . Me shkresen Nr 6274 dt 25.09.2018 derguar ne menyre shkresore dhe elektronike komisioni I vleresimit te ofertave ka kerkuar sqarime per argumentimin e ofertes duke lene si afat per pergjigjen dt 28.09.2018.

Shoqeria Alesjo sh.p.k nuk ka paraqitur asnje argumentim per oferten anomalisht te ulet ne kundershtim me percaktimin e bere ne nenin 66 pika 5 te VKM nr 914 date 29.12.2014 “Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Gjithashtu ne daten 28.09.2018 kjo shoqeri ka njoftuar nepermjet e-mailit se terhiqet nga oferta.

2. Bashkimi i operatoreve “Avdolli”shpk & “Vashtemi”shpk, per arsye se:

1.Shoqeria Avdolli sh.p.k nuk permbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 12,kriteret e vecanta te kualifikimit, **kapaciteti ekonomik dhe financiar**,pika 2 per arsye se nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2016.

2.Shoqeria Avdolli sh.p.k nuk permbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 12,kriteret e vecanta te kualifikimit, **kapaciteti teknik** pika 3.Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve per arsye se kjo shoqeri nuk ka kategorine NP 9 dhe NP 12 dhe ne marreveshjen e bashkepunimit kjo shoqeri ka marre persiper punime qe perfshihen ne keto kategori ne kundershtim me percaktimin e bere ne nenin 74 te VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” pika 3 ku percaktohet shprehimisht se : Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

3.Bashkimi i shoqerive nuk permbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 12,kriteret e vecanta te kualifikimit,**kapaciteti teknik** pika 4.2 ku perckatohet se Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar dhe te perfshire ne listepagesa **per periudhen Janar 2018 –Korrik 2018:**

Inxhinier Ndertimi	1 (nje)
Inxhinier Topograf	1 (nje)
Inxhinier Mjedisi	1 (nje)

per te cilet duhet te paraqiten:

I.diploma

II- kontrata e punes

III- CV

Asnje prej pjesetareve te bashkimit te shoqerive nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per te pakten nje inxhinier Mjedisi.

3. Bashkimi i operatoreve “Kuarci Blace”shpk & “Bahas”shpk, per arsye se:

1. Ne kontraten e bashkimit te shoqerive nuk eshte percaktuar perqindja e punimeve qe do te kryeje secili nga anetarët e bashkimit ne kundershtim me percaktimin e bere ne nenin 74 te VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” pika 2 ku percaktohet shprehimisht se : “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, **përqindja e pjesëmarrjes së punës**/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”

2. Shoqeria Kuarci Blace sh.p.k nuk permbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 12, kriteret e vecanta te kualifikimit, **kapaciteti teknik** pika 3. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve per arsye se kjo shoqeri nuk ka kategorine NP 9 dhe NP 12 nderkohe qe ne marreveshjen e bashkepunimit kjo shoqeri ka marre persiper punime qe perfshihen ne keto kategori, ne kundershtim me percaktimin e bere ne nenin 74 te VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” pika 3 ku percaktohet shprehimisht se : Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

3. Shoqeria Kuarci Blace sh.p.k nuk permbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 12, kriteret e vecanta te kualifikimit, **kapaciteti teknik** pika **2. Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat si me poshte**

- Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur Çertifikaten ISO 9001:2008/2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise”
- Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur Çertifikaten ISO 14001:2004/2015 Per menaxhim mjedisi
- Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur Çertifikaten OHSAS 18001:2007, Per manaxhim të shëndetit dhe sigurimit në punë

Per sa kohe Shoqeria Kuarci Blace sh.p.k ne marreveshjen e bashkepunimit ka marre persiper punime per te cilat eshte e nevojshme qe te jete pajisur me keto certifikata duhej ti kishte paraqitur ato sipas percaktimit te bere ne nenin 74 te VKM 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” pika 3 ku percaktohet shprehimisht se : Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

4. Shoqeria “Kacdedja”shpk, per arsye se:

Mbas kontrollit te preventivit te paraqitur rezultoi se jane bere gabime aritmetike konkretisht :

Ne preventivin “Rikonstruksion i nje prite malore TIP” eshte bere nje gabim gjate mbledhjes te nentotaleve. Vlera qe rezulton nga mbledhja e nentotaleve eshte 1928787 lek pa tvsh dhe jo 1866879 lek sic eshte shenuar nga ofertuesi .

Ne perfundim rezulton se nga mbledhja e nentotaleve te korrigjuara ne preventivin permbledhes vlera totale e ofertes pa tvsh eshte 16134382 (gjashtembedhjete milion e njeqind e tridhjete e kater mije e treqind e e tetedhjete e dy)lek dhe jo 15701026 (pesembedhjete milion e shtateqind e nje mije e njetzet e gjashte)lek sic eshte shenuar nga ofertuesi ne preventivin e paraqitur.

Per sa me siper bazuar ne nenin 66 te VKM nr 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik *“Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumet absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”*

5. Shoqeria “Biba - X” sh.p.k, per arsye se:

1.Preventivi i paraqitur nuk perputhet me preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor dhe konkretisht:

Ne preventivin me objekt “Rehabilitimi i pritave te perroit te fshatit Drenove, Fusha e I-re ne zerin “Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75” sasia e parashikuar nga autoriteti kontraktor ne preventivin e publikuar eshte 210 m³ ndersa sasia e vendosur nga ofertuesi eshte 250 m³

Preventivi i shpallur nga autoriteti kontraktor nuk mund te modifikohet nga ofertuesit.

Bazuar ne DST,Udhezime per ofertuesit, Seksioni 1 Hartimi i ofertes “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *shoqerine “Glavenica”shpk: me adresë: Fier, Ballsh, Lagj. 5 Shkurti, Bulevardi 4 Heronjte, godina nr.2, apartamenti nr.3, kati 4*, se oferta e paraqitur me një vlerë prej **9,856,977 (nente milion e teteqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e nenteqind e shtatedhjetë e shtate) leke pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme**

* * *

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë **Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa, per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 01.10.2018

Ankesa: JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**